

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6374  
E enjte, 29 korrik 2021  
çmimi 0.40 €

## Miratohet rishikimi i buxhetit për vitin 2021

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KOSOVA ME DHIMBJE TË THELLË KA VARROSUR TRUPAT E PAJETË  
TË BASHKATDHETARËVE QË HUMBËN JETËN TRAGJIKISHT NË KROACI

FAQE 4-5

# U JEPET LAMTUMIRA BASHKATDHETARËVE QË TRAGJIKISHT HUMBËN JETËN NË KROACI



Kosova ua ka dhënë lamtumirën e fundit viktimitave të aksidentit tragjik në Kroaci. Dhjetë trupat e pajetë, nëntë bashkatdhetarë dhe një nga shoferët e



autobusit që kanë arritur në Kosovë nga Kroacia, janë varrosur në vendlindjet e tyre të mërkurën. Në ceremonitë e varrimit të tyre kanë marrë pjesë mijëra qytetarë,

duke ndarë dhembjen me familjet e viktimitave. Kryeministri Albin Kurti ka deklaruar se kjo është një ditë me dhembje dhe pikëllim për mbarë popullin e Kosovës

## AKTUALE



**POLICIA DO T'I KONTROLLOJË  
AUTOBUSËT PËR GJENDJEN  
TEKNIKE DHE SHOFERËT** F. 3

**FABRIZI: DIALOGU ME  
KOSOVËN, KYÇ PËR  
PRANIMIN E SERBISË NË BE**

F. 3

**NË MUAJIN KORRIK NDODHËN  
13 RASTE TË DHUNËS  
NË FAMILJE NË GJILAN** F. 6



## EKONOMI



**DASH-i VLERËSON SE KOSOVA  
RUAJTI SEKTORIN FINANCIAR  
NGA NDIKIMI I COVIDIT** F. 8

**Rriten rastet  
me Covid në  
Kosovë, MSh-ja  
u bënë thirrje  
qytetarëve të  
vaksinohen** I FAQE 3



**Pulsi publik: Rritet  
kënaqshmëria e  
qytetarëve për punën  
e institucioneve** I FAQE 2



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**QEVERIA NDAN PESË  
MILIONË EURO SHITESË  
PËR SUBVENCIONIMIN  
E FERMERËVE** F. 8



**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

Endrit Shaqiri  
+38344685122

**INFINITY**  
Digital Agency  
Internet Website,  
Marketing...

## Bideni: Sulmet kibernetike mund të çojnë në luftë

WASHINGTON, 28 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, tha se sulmet e mëdha kibernetike në ShBA mund të çojnë në luftë të vërtetë. Bideni mbajti një fjalim para komitetit të inteligjencës. "Nëse përfundojmë në luftë - luftë të vërtetë, me të shtëna, me një fuqi të madhe, ajo do të jetë pasojë e një shkeljeje kibernetike me pasojë të mëdha", ka thënë Biden. Ai vuri në dukje një numër në rritje të sulmeve kibernetike kundër agjencive qeveritare dhe industrisë private në ShBA. Zyrtarët amerikanë i kanë lidhur këto sulme me Rusinë dhe Kinën. Disa prej tyre kanë ndodhur në gjashtë muajt e parë të presidencës Biden.

Qindra kompani amerikane janë prekur nga një sulm kibernetik, që është kryer më 2 korrik, kundër kompanisë së teknologjisë "Kaseya" me seli në Floridë. Në maj hakerët kanë sulmuar operatorin më të madh të tubacionit të karburanteve në ShBA, "Colonial Pipeline", ndërsa në qershor shënjestër e sulmit kibernetik ka qenë kompania më e madhe në botë për përpunimin e mishit, JBS. Biden ka biseduar me homologun rus Vladimir Putin për sigurinë kibernetike gjatë takimit të tyre në Gjenevë muajin e kaluar. Biden është zotuar se "do të ndërmarë çdo veprim të nevojshëm" për t'i ndaluar sulmet kibernetike nga Rusia, ka thënë Shtëpia e Bardhë.



## Nga e mërkura ndalohet mohimi i gjenocidit në Bosnje



SARAJEVË, 28 KORRIK - Në Bosnje e Hercegovinë mohimi i gjenocidit dhe lavdërimi i kriminelëve të luftës ndalohen nga dita e mërkurë, pasi plotësimet në Kodin Penal të Bosnjës, që u bënë nga përfaqësuesi i lartë i komunitetit ndërkombëtar, Valentin Inzko, dhe që dënojnë mohimin e gjenocidit dhe madhërimin e kriminelëve të luftës, hynë në fuqi. Një ditë më herët ato u publikuan në Gazetën Zyrtare të Bosnjës. Për shkelësit e Kodit Penal këto

ndryshime parashikojnë tani dënime me burg prej tre muajsh deri në pesë vjet. Vendimi i Inzkos për plotësimet, i publikuar më 23 korrik, nxitu reagime të ashpra nga Republika Serpska - entiteti i banuar me shumicë serbe në Bosnje. Anëtari serb i Presidencës trepalëshe të Bosnjës, Millorad Dodik, i cili vjen nga ky entitet, paralajmëroi se Bosnja mund të shpërbëhet dhe nisi një peticion për mospranimin e ndryshimeve

në Kodin Penal. Dodik mohoi se në Srebrenicë të Bosnjës ka pasur gjenocid. Gjatë luftës së viteve 1990 forcat serbe vranë mbi 8 000 burra dhe djem myslimanë në Srebrenicë. Vrasjet u njohën si gjenocid nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë. Përfaqësues të Republikës Serpske nisën të martën bojkotimin e institucioneve qendrore të Bosnjës për shkak të ndryshimeve në Kodin Penal.

## Dy njerëz të vdekur nga shpërthimi në Gjermani

BERLIN, 28 KORRIK - Së paku dy njerëz humbën jetën dhe 31 të tjerë u plagosën në një shpërthim të madh që ndodhi të martën në një park kimik në qytetin Leverkusen të Gjermanisë. Të dhënat i konfirmoi sot operatori i lokacionit, i cili tha se pesë persona janë ende të zhdukur. Shpërthimi ndodhi në Chempark, një nga parqet

më të mëdha industriale në botë. Operatori Currenta tha se kërkimet për pesë të zhdukurit vazhdojnë, por shpresa për gjetjen e të mbijetuarve "është duke u zvogëluar shpejt". Currenta tha se shpërthimi ndodhi në një pjesë të parkut ku gjenden mbeturinat dhe se nuk është ende e qartë se

çfarë e shkaktoi atë. Shpërthimi i madh aktivizoi alarmin e "rrezikut ekstrem" dhe bëri që zyrtarët t'u bëjnë thirrje banorëve pranë që të strehohen brenda dhe t'i mbyllin dritaret e tyre për ta shmangur kontaktin me tymin e madh. Matjet e cilësisë së ajrit më vonë treguan se ajri është në nivele të sigurta.



## Parashikime më të mira për ekonominë globale më 2022



WASHINGTON, 28 KORRIK - Fondi Monetar Ndërkombëtar rriti parashikimin për rritjen globale ekonomike në vitin 2022, por paralajmëroi se pabarazitë midis ekonomive të mëdha dhe atyre në zhvillim, sa i përket qasjes në vaksinat kundër koronavirusit, janë duke u thelluar. "Qasja në vaksina është shfaqur si linja kryesore, për gjatë të cilës rimëkëmbja globale ndahet në dy blloqe", ka njoftuar FMN-ja

në një azhurnim të Parashikimit Ekonomik Botëror të publikuar në prill. Sipas FMN-së, dy blloqet që kanë dalë janë "ato që mund të presin normalizim të mëtejshëm të aktivitetit ekonomik këtë vit dhe ato që do të përballen me infektim dhe rritje të numrit të viktimave nga koronavirusi". "Shërimi, megjithatë, nuk është i sigurt as në vendet ku infeksionet aktualisht janë

shumë të ulëta për aq kohë sa virusi qarkullon diku tjetër", ka njoftuar FMN-ja. Ekonomistja kryesore e FMN-së, Gita Gopinath, tha se "rimëkëmbja nuk është e sigurt derisa pandemia nuk mposhtet globalisht". Parashikimi për rritjen ekonomike globale në vitin 2022 u rrit në 4.9 për qind nga 4.4 për qind sa ka qenë në prill. Parashikimi i rritjes për këtë vit mbeti në 6 për qind.

# Rriten rastet me Covid në Kosovë, MSh-ja u bënë thirrje qytetarëve të vaksinohen



bërë thirrje të gjithë personave mbi 18 vjeç, që të vaksinohen kundër koronavirusit, ndërkohë që po përhapet varianti "Delta" i këtij virusi. Sipas kësaj ministrie, marrja e të dy dozave të vaksinës ul ndjeshëm rrezikun për sëmurje të rëndë apo vdekje nga ky virus. "Varianti 'Delta' i Covid-19 mund të përhapet më lehtë sesa variantet e tjera që qarkullojnë mes njerëzve, duke rritur kështu numrin e rasteve, shkallën e hospitalizimit dhe të vdekjeve, veçanërisht midis individëve jo të vaksinuar plotësisht", thuhet në njoftimin e MSh-së. Kryeministri Albin Kurti u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen kundër Covid-19. "Ju bëj thirrje ta caktoni terminin për vaksinim. Me kujtimin për të dashurit që humbëm nga pandemia, të kujdesemi për veten dhe njerëzit tanë të afërm duke u vaksinuar. Të përgjegjshëm individualisht dhe për njëritjetrin, bashkë ia dalim!", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Vaksinën kundër Covidit e ka marrë të mërkurën edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen. "Në kuadër të përbaljes me virusin Covid-19, sot u vaksinova me shpresë që të mbrohemi dhe të kemi sa më pak infeksione në vend. Për vlerësim dhe mirënjohje të lartë për punën e palodhshme të QKMF 'Adem Ukëhaxhaj' në Deçan, veçanërisht gjatë menaxhimit të krizës së helmimit të mbi 2 000 qytetarëve, dozën time të parë të vaksinës 'Pfizer-BioNTech' e mora në këtë institucion shëndetësor. Vaksinohu edhe ti. Mbroje veten dhe të tjerët!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Sipas të dhënave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), prej 3 669 testeve të kryera, 58 persona kanë rezultuar pozitivë me Covid-19, duke bërë kështu që të rritet numri i rasteve të reja me Covid në vendin tonë. Ministria e Shëndetësisë u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen kundër Covid-19. MSh-ja thekson se vaksinimi është e vetmja mënyrë për t'u mbrojtur nga varianti "Delta" i Covidit, i cili mund të përhapet më lehtë se variantet e tjera

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 KORRIK - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka regjistruar të mërkurën 58 raste të infektimit me Covid-19 pas testimit të 3 669 mostrave. Përgjatë 24 orëve të fundit nuk është regjistruar asnjë viktimë. IKShPK-ja ka njoftuar se më 28 korrik janë shëruar tre pacientë nga sëmundja Covid-19, ndërsa raste aktive janë 250. Prej 13 marsit 2020, kur janë regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë

regjistruar mbi 108 000 pacientë me këtë virus. Prej këtyre, 2 265 kanë vdekur.

Në Kosovë tashmë ka nisur programi i vaksinimit masiv kundër koronavirusit. Në këtë vend ka vaksina të prodhuesve "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZeneca".

Në 24 orët e fundit ndonjërin nga këto vaksina e kanë marrë 13 867 persona.

Numri i personave të vaksinuar me të dyja dozat e vaksinave ka shkruar në 124 226, ndërsa shifra totale e vaksinave të dhëna është 388 073.

Ministria e Shëndetësisë u ka

## Fabrizi: Dialogu me Kosovën, kyç për pranimin e Serbisë në BE

PRISHTINË, 28 KORRIK - Ambasadori i Bashkimit Evropian në Serbi, Sem Fabrizi, tha se dialogu midis Serbisë dhe Kosovës është një element kyç për anëtarësimin e Serbisë në Bashkimin Evropian. "Raundi i fundit i dialogut mund të ketë qenë më i vështiri nga të vështirët. Të dyja palët duhet t'i përkushtohen atij. Dialogu është një element kyç për stabilitetin rajonal dhe pranimin e Serbisë në BE. Ka interes të madh që dialogu të ketë sukses dhe BE-ja po bën të pamundurën për këtë", ka deklaruar Fabrizi për Radio-

Televizionin e Serbisë. Rundi i fundit i bisedimeve midis kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, u zhvillua më 19 korrik në Bruksel. Palët akuzuan njëra-tjetrën për mungesë të vullnetit që procesi të ecë përpara. Megjithatë, ato u pajtuan që t'i vazhdojnë bisedimet në shtator. Fabrizi ka theksuar se kushtet që Brukseli ia ka vënë Serbisë për anëtarësim në BE janë konstante dhe nuk ndryshojnë. "Dihet se për çfarë bëhet fjalë - dialogu me Prishtinën, sundimi i ligjit, reformat ekonomike,

prokurimi publik, subvencionet, ndihma shtetërore janë gjëra për të cilat duhet të punohet", është shprehur Fabrizi.

Serbia ka hapur disa kapituj të negociatave për anëtarësim në BE.

Nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, negociatat e anëtarësimin i ka hapur edhe Mali i Zi. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria mbeten në pritje të nisjes së këtyre negociatave, ndërsa Kosova dhe Bosnje e Hercegovina kanë vetëm marrëveshje stabilizim asociimi me BE-në, që është hapi i parë drejt anëtarësimin në bllok.





KOSOVA ME DHIMBJE TË THELLË KA VARROSUR TRUPAT E PAJETË TË BASHKATDHETARËVE QË HUMBËN JETËN TRAGJIKISHT NË KROACI

# U jepet lamtumira bashkatdhetarëve që tragjikisht humbën jetën në Kroaci

Kosova ua ka dhënë lamtumirën e fundit viktimave të aksidentit tragjik në Kroaci. Dhjetë trupat e pajetë, nëntë bashkatdhetarë dhe një nga shoferët e autobusit që kanë arritur në Kosovë nga Kroacia, janë varrosur në vendlindjet e tyre të mërkurën. Në ceremonitë e varrimit të tyre kanë marrë pjesë mijëra qytetarë, duke ndarë dhembjen me familjet e viktimave. Kryeministri Albin Kurti ka deklaruar se kjo është një ditë me dhembje dhe pikëllim për mbarë popullin e Kosovës

**EPOKA ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 28 KORRIK** - Me ceremoni të ndara varrimi Kosova ua ka dhënë lamtumirën e fundit dhjetë trupave të pajetë, nëntë bashkatdhetarëve dhe shoferit të autobusit që ndërjuan jetë të dielën në aksidentin tragjik në Kroaci. Në ceremonitë e varrimit të tyre kanë marrë pjesë mijëra qytetarë, duke ndarë dhembjen me familjet e viktimave që kanë humbur jetën në aksidentin tragjik. Trupat e pajetë që pësuan nga aksidenti i autobusit në Kroaci kanë arritur në Kosovë

të mërkurën rreth orës 13:00. Karvani i makinave që i solli ato ka udhëtuar nga Kroacia përmes Malit të Zi dhe Shqipërisë. Liderët institucionalë ditën e mërkurë e kanë vlerësuar ditë të rëndë për Kosovën. Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka deklaruar se e tërë Kosova është pllakosur në zi nga kjo tragjedi. "Të nderuara familje Binakaj, Rrustemi, Kolmekshaj, Kastrati, Bellanica, Maloku, Hoxha, Iprijaj e Sylmetaj, si dhe të afërm e miq të bashkatdhetarëve që humbën jetën në aksidentin tragjik të së dielës, jo vetëm ju, por e tërë

Kosova është pllakosur në zi dhe mbytur në dhimbje për bashkatdhetarët tanë të dashur që pësuan në fatkeqësinë tragjike afër Slavonski Brodit të Kroacisë derisa po ktheheshin në atdhe nga mërgimi për pushime çmallëse", ka shkruar Konjufca në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka ngushëlluar familjarët dhe është lutur për shërimin e të lënduarve. "Në këto momente tejet tronditëse për ju që humbët më të dashurit tuaj dhe për mbarë Kosovën, jemi bashkë dhe pranë njëri-tjetrit për të shprehur solidaritetin vëllazëror, për të ndarë

dhimbjen dhe për ta përballuar më lehtë pikëllimin për jetët e humbura në këtë tragjedi të dimensioneve tejkombëtare, si dhe për t'u lutur për shërimin e të lënduarve. Ngushëllimet tona më të sinqerta familjeve, të afërmeve dhe miqve për humbjen e më të dashurve të tyre. U qoftë i lehtë dheu i Kosovës!", ka shkruar Konjufca. Në hapje të mbledhjes së qeverisë edhe kryeministri Albin Kurti ka shprehur ngushëllime për të gjitha familjet që kanë humbur më të dashurit e tyre në fatkeqësinë e rëndë të komunikacionit në afërsi të Slavonski Brodit, në Republikën e Kroacisë. "Në emër të qeverisë dhe në emrin tim personal u shpreh edhe një herë ngushëllime familjarëve që humbën të dashurit e tyre në aksidentin tragjik në Kroaci. Sot u kthyen në Kosovë trupat e bashkatdhetarëve tanë që nuk i mbijetuan aksidentit. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal

Sveçla, ka pritur kortezhin në pikën kufitare në Vermicë, kurse ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, tani është afër morgut të Prizrenit. Është një ditë me dhembje dhe pikëllim për mbarë popullin tonë", ka thënë Kurti, duke iu dëshiruar shërim të shpejtë të lënduarve. "Mbrëmë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës 'Adem Jashari' kemi pritur 21 bashkatdhetarë të cilët i mbijetuan aksidentit tragjik në Slavonski Brod të Kroacisë. Të lënduarve u kemi uruar shërim të shpejtë dhe të plotë, duke i siguruar se do ta kenë përkujdesjen tonë institucionale. Qeveria e Kosovës do t'u qëndrojë pranë bashkatdhetarëve me të gjitha mundësitë që t'ua lehtësojmë dhimbjet nga pasojat e aksidentit", ka deklaruar ai. Kryeministri Kurti ka shprehur mirënjohje për shtetin e Kroacisë për menaxhimin e situatës së rëndë të krijuar pas

aksidentit tragjik. “Edhe një herë u shpreh mirënjohje të gjitha institucioneve shtetërore të Kroacisë, në veçanti kryeministrit Andrej Plenković për ndihmën e pakursyer në këtë situatë të rëndë”, është shprehur Kurti.

### Të mbijetuarit e aksidentit arrijnë në Kosovë

Të mbijetuar e aksidentit rrugor në Kroaci arritën të martën mbrëma në Kosovë.

Avioni që është nisur nga Osijeku ka aterruar në Prishtinë pak pas orës 22:00 të ditës së martë. Qeveria e Kosovës përmes një komunikate për media ka njoftuar se 21 të mbijetuarit e këtij aksidenti kanë arritur në Kosovë. Ata u pritën nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca dhe



kryeministri Albin Kurti, ndërsa u shoqëruan më pas nga familjarët e tyre. Më pas, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, në një konferencë për media ka thënë se gjendja e të liruave është stabile. “Nga ky aksident kanë mbetur të vdekur dhjetë persona, fillimisht 43 kanë qenë të hospitalizuar. 28 veta janë liruara nga spitali dhe 15 të tjerë po vazhdojnë trajtimin në Kroaci. Një nga pacientët është transferuar në spitalin e Zagrebit. Fatmirësisht gjendja e saj është stabile dhe nevojiten edhe disa ditë për 15 pacientët e tjerë. Kuptohet se gjendja e tyre është stabile, përveç dy pacientëve që janë në Intensivë. Njëri është në gjendje të rëndë, ndërsa tjetri është jashtë rrezikut

për jetë. Katër nga bashkatdhetarët tanë kanë vendosur të kthehen në Gjermani për trajtim të mëtutjeshëm, kurse gjashtë të tjerë pritet të lirohen në ditët në vijim”, ka deklaruar Vitia.

Dhjetë veta me prejardhje nga Kosova kanë humbur jetën të dielën kur autobusi me të cilin udhëtonin doli nga rruga në qytetin Sllavonski Brod të Kroacisë.

Autobusi me 67 pasagjerë, përfshirë fëmijë, ishte nisur nga Frankfurti për në Prishtinë. Shoferi është ndaluar në vendin e ngjarjes, ndërsa të martën i është caktuar masa e paraburgimit prej 30 ditësh. Në ndërtim të këtyre viktimave, Kosova ka mbajtur ditë zie të hënën.

## Policia do t'i kontrollojë autobusët për gjendjen teknike dhe shoferët

FERIZAJ, 28 KORRIK (ER) - Drejtorja Rajonale e Policisë në Ferizaj, përkatësisht Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor, pas aksidentit tragjik që ndodhi më 25 korrik në Kroaci, ku humbën jetën dhjetë qytetarë nga Kosova dhe disa të tjerë u lënduan rëndë dhe lehtë, të mërkurën i ka ftuar në një takim kompanitë e transportit publik të udhëtarëve nga rajoni i Ferizajt.

Në këtë takim është diskutuar për situatën e sigurisë në komunikacion, e cila është vlerësuar të jetë e mbingarkuar nga qarkullimi i automjeteve në rrugë, ndërkaq është paraqitur nevoja që urgjent të merren masa, të nevojshme nga përgjegjësit e kompanive të transportit publik të udhëtarëve, me theks të veçantë transportit ndërkombëtar për ta shtuar kujdesin e tyre.

Nga policia janë dhënë rekomandime që kompanitë e transportit publik të udhëtarëve, të sigurohen se a kanë caktuar drejtues (shoferë) të autobusëve me përvojë, të sigurohen se këta shoferë a janë në gjendje të mirë shëndetësore, bazuar edhe në certifikatat e tyre mjekësore, siç është përcaktuar me ligj, të sigurohen gjithashtu se, a janë duke i respektuar të gjitha rregullat dhe ligjet e komunikacionit rrugor, edhe sa i përket kohëzgjatjes së drejtimit të autobusit dhe a janë të pranishëm edhe ndihmëssoferët gjatë transportit në linjat ndërkombëtare, si dhe masat e tjera mbi gjendjen teknike të këtyre automjeteve.

Në fund të këtij takimi u tha të mbahet edhe një takim tjetër gjatë javës edhe me përfaqësues të institucioneve lokale dhe qendrore



nga fusha e transportit. Përfaqësuesit e policisë, pas këtyre sugjerimeve dhe rekomandimeve që u dhanë nga përfaqësuesit e

këtyre kompanive, do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të bërë kontrole të jashtëzakonshme të tyre si për shoferët, ashtu edhe

për gjendjen teknike të autobusëve dhe për çdo parregullsi do të marrin masa adekuate sipas Ligjit të Komunikacionit Rrugor.

## Në muajin korrik ndodhën 13 raste të dhunës në familje në Gjilan

**GJILAN, 28 KORRIK (ER)** - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) e ka vlerësuar të qetë gjendjen e sigurisë në komunën e Gjilanit, ndërkohë që ka kërkuar nga qytetarët rezidentë që të përmbahen nga daljet pa nevojë në qytet gjatë kohës derisa janë këtu mërgimtarët për t'u lënë më shumë hapësirë e mundësi atyre që t'i shijojnë pushimet në vendlindje.

Naser Rrahmani, zëvendëskomandant i Stacionit Policor në Gjilan, ka thënë se gjendja e mirë e sigurisë është rezultat i kontributit të qytetarëve të kësaj komune, angazhimit të organeve të rendit si dhe i bashkëpunimit të policisë me komunitetin.

Ai ka rikujtuar se tani që jemi në kohën e pushimeve dhe si rezultat i lehtësimit të masave anti-Covid, ka një fluks të mërgimtarëve të cilët kanë

ardhur dhe po vazhdojnë të vijnë në vendlindje për pushime dhe kjo po vërehet nga tollovitë që po krijohen në rrugë dhe trafik.

Rrahmani ka thënë se në lidhje me këtë situatë, Stacioni Policor ka përgatitur edhe planin operativ të cilin do ta zbatojnë në terren dhe ka të bëjë me ngasjen e veturave, shpejtësinë, ndalimin në vendet e ndaluara, përdorimin e alkoolit, përdorimin e telefonit dhe masave të tjera që ndikojnë në sigurinë e komunikacionit.

Ndërkaq sa iu përket veprave penale, Rrahmani tha se gjatë muajit korrik janë regjistruar 13 raste të dhunës në familje, ndërsa 'vjedhje' dhe 'vjedhje të rënda' janë raportuar 24 raste, përfshirë edhe fshatin Malishevë, ku policia është duke vazhduar zbatimin e planit operativ dhe kohën e fundit nuk ka pasur



raste të reja të vjedhjes atje. Si rezultat i punës hetimore, janë arrestuar dy persona, ndërsa dy

të tjerë janë në kërkim, në lidhje me vjedhjet masive që kanë ndodhur në komunën e Gjilanit dhe dyshohet se janë të përfshirë edhe në fshatin Malishevë.

## Filloi vendosja e numrave në shtëpitë dhe objektet e tjera në komunën e Malishevës

**MALISHEVË, 28 KORRIK (ER)** - Ka filluar vendosja e numrave për shtëpitë dhe objektet e tjera në kuadër të zbatimit të projektit për vendosjen e numrave për shtëpitë dhe objektet e tjera përmes së cilës edhe plotësohet adresa e saktë e një shtëpie apo hyrje e objektit të caktuar.

Në këtë fazë do të vendosen katër mijë numra në tetë vendbanime. Fillimin e vendosjes së numrave për shtëpitë dhe objektet në qytetin e Malishevës e ka inspektuar drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina, pasi ky projekt realizohet përmes kësaj drejtorie.

Drejtori Morina ka bërë me dije se në këtë fazë janë të përfshira shtatë fshatra dhe qyteti, dhe do të vendosen katër mijë numra. Sipas tij, ky projekt mundësohet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe financohet nga qeveria norvegjeze.



## Vazhdon regjistrimi i fëmijëve për aktivitetin tradicional të bibliotekës "Java e leximit"



**PRIZREN, 28 KORRIK (ER)** - Fëmijët përmes motos "Të luajmë duke mësuar, të mësojmë duke luajtur" do ta kenë mundësinë që për pesë ditë, nga 16 gushti deri më 20 gusht, të jenë pjesë e aktivitetit veror ku, përveç mësimëve, do të kenë edhe argëtime të shumta. "Fëmijët e moshave 11-13-vjeçar mund të regjistrohen çdo ditë

pune në bibliotekë. Prindër, aktivizoni fëmijët tuaj që edhe gjatë pushimeve të jenë aktivë si dhe të parapërgatiten për fillimin e vitit të ri shkollor. Biblioteka gjithë fëmijëve u dëshiron pushime të këndshme dhe i fton që edhe gjatë pushimeve libri të mbetet miku juaj!", ka njoftuar komuna e Prizrenit.

## Asfaltohet rruga në lagjen Bujupi në Arllat të Drenasit

**DRENAS, 28 KORRIK (ER)** - Në kuadër të planit për realizimin e projekteve infrastrukturore për vitin 2021, Drejtoria e Infrastrukturës Lokale në komunën e Drenasit është duke vazhduar realizimin e tyre në vendbanime për ta përmirësuar jetën e qytetarëve.

Drejtori i Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva, së

bashku me anëtarin e Kuvendit, Burim Bujupi, dhe banorë të fshatit Arllat, të mërkurën kanë mbikëqyrur punimet e asfaltimit të rrugës në lagjen Bujupi të fshatit Arllat, ku kjo rrugë është asfaltuar sipas planit të paraparë.

Drejtori Gllareva ka vlerësuar realizimin e këtij projekti si një rëndësi e

veçantë për banorët e lagjes Bujupi në Arllat dhe ka shtuar se gjatë këtij viti do të asfaltohen edhe rrugica të tjera në lagjen e xhamisë dhe në lagjen Bytyqi.

Asfaltimi i rrugës në lagjen Bujupi është i gjatësisë mbi 930 metra, ndërsa shumë shpejt pritet të fillojë asfaltimi i rrugëve edhe në lagjen e Xhamisë dhe në lagjen Bytyqi.



## Qeveria ndan 430 mijë euro për specializantët

PRISHTINË, 28 KORRIK (ER) - Qeveria e Kosovës në mbledhjen të mbajtur të mërkurën ka ndarë 430 mijë euro për Ministrinë e Shëndetësisë, mjete këto që do të përdoren për pagesën e specializantëve për muajin korrik 2021. Me propozimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, qeveria ka miratuar vendimin për rialokim

të mjeteve në shumën prej 500 mijë eurosh. Mjetet e rialokuara do të përdoren për realizimin e 11 marrëveshjeve të mirëkuptimit për realizimin e projekteve kapitale të nënshkruara në mes të ministrit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kryetarëve të komunave. Miratimin e qeverisë e ka marrë edhe propozimi tjetër i Ministrisë

së Administrimit të Pushtetit Lokal për rialokimin e mjeteve në shumën prej 150 mijë eurosh për projektin kapital "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit" në komunën e Deçanit në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar nga ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kryetarit të komunës së Deçanit.



# Pulsi publik: Rritet kënaqshmëria e qytetarëve për punën e institucioneve

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 KORRIK - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka lansuar të mërkurën edicionin e 20-të të përmbledhjes pulsi publik përmes një paraqitje virtuale të të gjeturave kryesore. Gjetjet e anketës të opinionit të pulsit publik të majit 2021 tregojnë një rritje domethënëse të kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e institucioneve kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore të Kosovës, krahasuar me anketën e mëparshme të realizuar në dhjetor të vitit 2020. Kënaqshmëria e regjistruar me performancën e kabinetit të ekzekutivit është 59.1 për qind, gjë që përbën një rritje prej 37.8 pikë përqindje në krahasim me anketën e dhjetorit 2020 kur kjo vlerë ishte 21.3 për qind. Niveli i regjistruar i kënaqshmërisë me punën e kryeministrit është 59.5 për qind (23 për qind në dhjetor 2020), ndërsa kënaqshmëria me punën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës është rritur nga 46.7 për qind në dhjetor 2020 në 59.2 për qind në maj 2021.

Niveli më i lartë i kënaqshmërisë prej 63.7-përqindësh është regjistruar me punën e presidentes së Kosovës, krahasuar me 33.9 për qind të regjistruar në dhjetor 2020.

Indeksi i Demokratizimit (ID) është rritur me 0.26 pikë (1.58) krahasuar me dhjetorin 2020, kur kjo vlerë ishte 1.32 pikë që tregon se shumica e respondentëve janë të kënaqur me trendët



demokratikë në Kosovë.

Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE) është rritur nga dhjetori 2020 (0.84) dhe ka arritur në 1.49 pikë, duke treguar një rritje të konsiderueshme të besimit të qytetarëve në perspektivën ekonomike të Kosovës.

Gjetjet tregojnë edhe rritje

thelbësore të ndjenjës së sigurisë te të anketuarit, me 76.4 për qind që ndihen të sigurt kur janë jashtë (në publik), krahasuar me 68.4 për qind të regjistruar në dhjetor 2020.

Tri problemet kyçe me të cilat Kosova aktualisht ballafaqohet janë papunësia (34.3 për qind), varfëria (19.3 për qind) dhe

korruptioni (9.3 për qind).

Serbët e Kosovës e konsiderojnë papunësinë (16.7 për qind), sigurinë publike dhe personale (14.8 për qind) dhe problemet e hapësirës urbane (12.9 për qind) si tri problemet më të mëdha, ndërsa për komunitetet e tjera të Kosovës problemi më i madh është papunësia (51.2 për qind),

ndjekur nga varfëria (18.9 për qind) dhe furnizimi me energji (11.4).

Respondentët u shprehën mesatarisht të kënaqur me reagimin e institucioneve të Kosovës ndaj pandemisë Covid-19 me 43.6 për qind të kënaqur me masat e ndërmarra nga kabineti ekzekutiv.

## Deklaratë e përbashkët e kryetarit të Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajt për zgjedhjet lokale

Mitrovicë, 28 korrik (ER) - Kryetari i Mitrovicës, Vushtrrisë e Skenderajt kanë zhvilluar një takim të përbashkët në prag të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit 2021, ku kanë diskutuar për mbarëvajtjen e zgjedhjeve lokale.

Kryetari Agim Bahtiri, Bekim Jashari e Xhafer Tahiri i kanë ofruar gjithë mbështetjen logjistike KKZ-ve në mënyrë

që zgjedhjet të organizohen sa më mirë.

Të tre kryetarët ftojnë mediat lokale që në prag të zgjedhjeve, por edhe gjatë fushatës, të jenë të paanshme e ta informojnë publikun drejt për të gjitha zhvillimet në komunat e regjionit 02.

Në këtë drejtim, kryetari Bahtiri, Jashari e Tahiri shprehin shqetësimin e tyre për disa portale si "Jepi zë" që

në javët e fundit me shkrime të pabazuara e tendencioze janë vënë në shërbim të përhapjes së lajmeve të pabazuara që dezinformojnë qytetarin e publikun.

Kryetarët e këtyre komunave mirëpresin bashkëpunimin me portalet e mediat lokale, por nuk i nënshtrohen shantazhit që ka për qëllim përfitim material në funksion të "lajmeve pozitive".



# DASH-i vlerëson se Kosova ruajti sektorin financiar nga ndikimi i Covidit

PRISHTINË, 28 KORRIK - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka mirëpritur raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për klimën e investimeve për vitin 2021, i cili njih zhyllimet në sektorin financiar. “Raporti i DASH-it vlerëson se sistemi rregullativ është në pajtueshmëri me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare. Nuk ka kufizime përtej kërkesave normale rregullatore në lidhje me burimin e kapitalit, përshtatjen dhe aftësinë e investitorëve”, është thënë në komunikatën e BQK-së.

Raporti në fjalë thekson se BQK-ja ka marrë të gjitha masat e kërkuara për t'i përmirësuar politikat për rrjedhën e lirë të burimeve financiare. Gjithashtu,

theksohen përmirësimet e vazhdueshme të qasjes në kredi të sektorit privat, ndërsa investitorët e huaj mund të marrin kredi dhe mund të hapin llogari bankare. “Sipas parashikimeve të FMN-së, ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2020 kishte rënie prej 6-përqindësh për shkak të Covid-19, sektori bankar mbetet mirë i kapitalizuar dhe profitabil. Raporti vlerëson se shërbimet financiare dhe huadhënia bankare janë përmirësuar dukshëm vitet e fundit. Në mars 2021 kreditë joperformuese janë në nivelin prej 2.7-përqindësh, përderisa normat e interesit kanë rënë dukshëm, nga një mesatare prej 12.7-përqindësh që ishin në vitin 2012, në një mesatare prej 3.1-përqindësh në marsin e vitit



2021”, është thënë në komunikatën e BQK-së, duke shtuar se lejohet transferimi i fondeve në tregjet e huaja ose shndërrimi në valutë të huaj, të cilat duhet të përpunohen në përputhje me procedurat bankare të BE-së. “Kosova nuk zbaton asnjë lloj kontrolli të kapitalit ose kufizime në flukset ndërkombëtare të kapitalit dhe, si e tillë, qasja në këmbimin e valutave të huaja për dërgesat e investimeve është e liberalizuar plotësisht. Pavarësisht prej tronditjeve nga Covid-19 në të gjitha ekonomitë botërore, në vitin 2020 remitancat në Kosovë ishin të qëndrueshme dhe shënuan rritje prej 15.1-përqindësh ose mbi 1.2 miliard dollarë”, theksohet në komunikatën e BQK-së.

## Miratohet rishikimi i buxhetit për vitin 2021



**EPOKA E RE**

**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 KORRIK - Deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë miratuar në lexim të dytë Ligjin për rishikimin e buxhetit. 69 deputetë votuan për, asnjë

kundër dhe asnjë abstenim. Vetëm një amendament i opozitës ka kaluar nga 35 sa ishin gjithsej. Bëhet fjalë për ndërtimin e një çerdheje në Skenderaj të propozuar nga Blerta Deliu e PDK-së. Buxheti i rishikuar për vitin 2021

është rreth 2.5 miliardë euro, ndërsa të hyrat do të jenë 2 miliardë e 43 milionë euro. Ky është buxheti më i madh që ka pasur Kosova deri më tani pavarësisht prej problemeve gjatë këtyre dy vjetëve si pasojë e pandemisë Covid-19.

Me rishikimin e buxhetit për vitin 2021 shkalla nominale e rritjes ekonomike është 7.9 përqind, kurse të ardhurat e buxhetit janë rishikuar me ngritje rreth 150 milionë euro. Po në këtë rishikim të buxhetit është përfshirë edhe Pakoja e

Ringjalljes Ekonomike në shumën prej 420 milionë eurosh. Kjo pako përmban pesë grupe të masave të përqendruara për rritjen e punësimit dhe riorientimin e kapitalit drejt një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm.

## Qeveria ndan 5 milionë euro shtesë për subvencionimin e fermerëve

PRISHTINË, 28 KORRIK (ER) - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të mërkurën që të ndajë 5 milionë euro shtesë

mbështetje financiare për fermerë. Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka thënë se kjo përkrahje

financiare është më e madhja e realizuar ndonjëherë. “Do t'i përmbyllim shpejt të gjitha

pagesat e dyta për këtë vit, njëkohësisht po bëjmë të mundur shpalljen për vitin 2021”, ka thënë Peci.







WILLIAM BUTLER YEATS

# SOCIOLOGJIA E FESË\*\*\*

Para se të fillojmë të flasim për sociologjinë e fesë, le të kujtojmë edhe një herë se sociologjia është një shkencë e së vërtetës, një shkencë e fakteve/ngjarjeve. Sociologjia është e detyruar të mendojë pa dhënë gjykime vlerore. Në këtë disiplinë shkencore duhen lënë mënjanë gjykimet vlerore dhe qëndrimet vetjake. Ngjarjet duhen trajtuar dhe analizuar ashtu siç janë.

Por, në veçanti në fushën e sociologjisë, nuk është e lehtë që të realizohet ky determinizëm metodologjik, pasi ngjarjet shoqërore nuk përbëjnë dukuri si ngjarjet natyrore të cilat mund të vëzhgohen nga jashtë. Ato janë ngjarje në të cilat marrim pjesë edhe personalisht.

Në fushën e sociologjisë së fesë kjo është edhe më e vështirë. Feja vepron deri në shtresat më të thella të personalitetit. Kështu, mund të themi se nëse ka një dukuri ku njeriu merr pjesë me gjithë qenien e tij, ajo është feja. Për këtë arsye, duhet një analizë shumë e kujdesshme nëse mund të marrim një qëndrim objektiv ndaj dukurive religjioze, të pavarur, jashtëvlerore dhe shkencore.

Le të supozojmë se një sociolog analizon grupet e interesit të cilat janë pjesë e jetës shoqërore dhe ekonomike moderne. Sociologu, që në fund të hulumtimit të tij konstaton se pjesë-tarët e një grupi interesi mbrojnë interesat e tyre duke shtruar kërkesa në

kundërshtim me interesat e tërësisë shoqërore, mund të hapë një front ndaj interesave të një grupi të caktuar. Pavarësisht prej këtij rreziku, konstatimet e arritura duhet t'i përcillen në mënyrë të drejtpërdrejtë opinionit publik.

Nuk janë vetëm fuqitë e jashtme apo brenga se me qëndrimet shkencore prekim interesat materiale të të tjerëve, që në fushën e sociologjisë së fesë e pengojnë qasjen ndaj çështjeve nga një pikëpamje shkencore objektive.

Përkundrazi, problemet janë të brendshme, burojnë nga vetë ne sepse, duke përveshur krahët për të studiuar një problematikë, edhe vetë ne shkelim në një fushë të shenjtë. Por, pavarësisht prej gjithë kësaj, duhen respektuar normat që vlejné për të gjitha disiplinat shkencore. Pa dyshim që ka ndryshim mes besimit në një fe dhe shndërrimit të saj në objekt studimor. Megjithatë, duhet ngulmuar te qasja objektive. Për këtë arsye, mendimi ynë shkencor ballafaqohet me një presion që vjen nga brenda. Sociologët bashkëkohorë të fesë i kanë tipologjizuar fetë në bazë të disa kriterëve të cilat ngjajnë me kriteret e zoologëve kur tipologjizojnë insektet apo fluturat. Më tej duhet menduar nëse feja mund të kuptohet/rruket në distancë dhe në një mënyrë shpërfillëse; pasi në trajtimin teorik të çështjes dhe

në të menduarit abstrakt të saj ndihen ca përpëlitje nga inkuadrimi ynë i brendshëm. Në të kundërt, kjo do të thotë se po trajtojmë disa matrica të vdekura, realitetin jofetar. Përveç kësaj, duhet ta shtyjme veten që të japim vlerësime teorike të paanshme. Ky presion i brendshëm dhe i thellë nuk mund të shmanget nga hulumtimet e sferës së sociologjisë së fesë. Nuk duhet të kemi frikë nga ky presion. Duhet të përpiqemi vazhdimisht që të ngadhënjëjmë mbi të.

Një nga vështirësitë në analizat dhe hulumtimet e sociologjisë së fesë është edhe fakti se mbi sipërfaqen e tokës ekzistojnë fe të ndryshme për nga përmbajtja e besimit, për nga mënyra e perceptimit të së shenjtës, si dhe për nga mënyra e kryerjes së ritualeve dhe adhurimeve. Nëse marrim parasysh jo vetëm besimet e kohës së sotme, por edhe ato nga kohët e para të njerëzimit, ky pohim përforcohet edhe më tepër.

Madje edhe te fetë e gjalla sot - dhe në veçanti tek ato që janë shfaqur në periudha shumë të hershme të historisë - ka gjëra që na duken të huaja, të panjohura, të cilat përpiqemi t'i kuptojmë në këtë apo në atë mënyrë. Ngjashëm me këtë, vëmë re edhe dallime vlerore, madje edhe mes feve të mëdha. Nga njëra anë perceptime shumë të thjeshta dhe të ashpra, nga ana tjetër

mendime madhështore, që gjejnë shprehje të fetë e larta.

Sociologjia e fesë është e detyruar që t'i marrë parasysh të gjitha këto dukuri që reflektohen te jeta fetare. Këndvështrimi i saj duhet të jetë universal, të mos mohojë dallimet ndërjetare dhe mospërputhjet vlerore. Për sociologjinë e fesë është e rëndësishme që t'i analizojë edhe fetë më primitive të komuni-teteve që janë të gjalla edhe sot.

Faktorin fe do ta hasim gjithnjë, pavarësisht se sa thellë zbesim në histori, madje edhe në periudhat parahistorike. Individit, që nga kulturat më primitive, ka jetuar brenda grupeve shoqërore, ka jetuar i lidhur pas një feje të caktuar. Edhe në faza të tilla të historisë ka besuar në ekzistencën e disa qenieve misterioze, ka kërkuar rrugët për të hyrë në marrëdhënie me to; ka lodhur kokën lidhur me jetën pas vdekjes; ka besuar në idhuj (fétiche), në gjëra që sjellin fat, te të cilat ka përmbajtje (si)fetare. Por, ndryshimi vleror mes një besimi të tillë dhe feve të larta përbën një fakt me peshë për sociologjinë e fesë. Madje edhe fetë e fiseve të vjetra, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga vlerat, ndryshojnë shumë nga ajo që ne quajmë fe sot. Besimet politeiste të grekëve, romakëve, egiptianëve antikë, të sumerëve dhe hititëve kanë ndikuar shumë në kulturën e këtyre popujve. Çdo

festë e tyre ka pasur një kuptim fetar; çdo marrëveshje është bërë në emër të hyjnive; çdo garë sportive ka përfunduar me një ritual fetar. Ndonëse besimi i këtyre popujve ndryshon shumë nga ai yni, sepse ishte politeist, perëndive u janë përshkruar tipare njerëzore; janë perceptuar si qenie konkurrenente dhe në luftë me njëra-tjetrën, prapëseprapë mund të themi se edhe ata kanë pasur shenjtërinë e vet.

Lindja e feve monoteiste përbën një pikë kthese në historinë e njerëzimit, shënon ngjarjen më të rëndësishme në histori. Filozofi gjerman Karl Jaspers (1883-1969) këtë çast e cilëson si pikë kthese në historinë botërore. Në shek. VII dhe VI p.e.s. kanë vepruar profetët e mëdhenj të përmendur në Dhiatën e Vjetër, zoroastrianizmi në Persi (630-553 p.e.s.), Buda në Indi (563-483 p.e.s.), Konfuci në Kinë (557-479 p.e.s.) dhe Lao Ceja (604-? p.e.s.). Fetë e vërteta monoteiste do të shfaqen në mijëvjeçarin e ardhshëm.

Sociologjia e fesë është e detyruar t'i marrë parasysh të gjitha fetë e llojit njerëzor. Por, duhet shënuar se kjo nuk nënkupton edhe relativizimin e dallimeve vlerore mes feve popullore politeiste dhe feve të larta monoteiste.

Në kërkimet e sociologjisë së fesë, feja duhet trajtuar si një entitet që ndikon te çdo individ, që vendoset dhe lëshon rrënjë, që

i kapërcen njerëzit dhe objektivizohet, që luan rolin e urës ndërmjet tyre.

Rudolf Ottoja (1869-1937) është shkencëtari i parë që është munduar ta përkufizojë cilësinë kryesore të fesë. Sipas këtij përkufizimi, që më pas është pëlqyer edhe nga shumë studiues të fesë, feja është “përjetimi i të shenjtës” (das Erlebnis des Heiligen). Ky përkufizim nuk është i zbrazët, ndonëse në shikim të parë duket shumë formal dhe i paqartë. Para së gjithash, ai flet për kapacitetin e njeriut për të përjetuar të shenjtën; flet për atë se kjo përvojë është një nevojë qenësore e tij. Ndërkohë shpjegon edhe të vërtetën se feja është e vendosur në vetëdijen e njeriut. Kjo sepse përvoja (erlebnis) është e lidhur gjithmonë me vetëdijen, me shpirtin, me njeriun, me individin.

Të vërtetën e pakontestueshme se feja, para së gjithash, është çështje individuale, një gjendje e brendshme e përjetuar nga njeriu, e mësojmë nga fetë e larta. Te të gjitha fetë e mëdha ka thënie lakonike, të thella, që flasin për shpirtin individual që i thërret njerëzit të besojnë.

Megjithatë, përvoja tregon se përjetimet e thella të fesë nuk janë vetëm individuale. Ndjesia fetare kalon dhe përjetohet edhe nga të tjerët. Prej përjetuesit të parë feja pasqyrohet edhe te të tjerët. Ja pra, ky është fillimi i ndikimit të burimit bashkëindërtues të fesë. Ndoshta mund të kuptohet si një kontradiktë fakti që menjëherë pas theksimit se ajo vendoset dhe lëshon rrënjë në vetëdijen e individit, flasin për përmasën bashkëindërtuese të fesë. Vërtet ekziston një urë mes lindjes së përjetimit fetar dhe komunikimit të tij te të tjerët, pra mes dy fakteve të objektivizimit, mes ndjesisë dhe bashkësisë fetare.

Studimet e shumta flasin se përvoja fetare objektivizohet në tri mënyra:

i. Çdo jetë fetare është e lidhur me perceptime të caktuara. Këto perceptime mund të formohen nga disa elemente materiale, ide përshkruese dhe konkrete. Te fetë politeiste përmbajtja e perceptimeve fetare është konkrete, është identiteti i disa elementeve përshkruese; domethënë është e lidhur me një mit. Përkundër kësaj, te fetë e larta kjo përmbajtje ngrihet në mendime abstrakte, në doktrinë fetare.

Përmbajtja e perceptimeve specifike të një feje ka forcë për bashkimin e individëve. Kjo përmbajtje i kapërcen individët dhe kryen funksionin e një ure që i lidh ata me njëri-tjetrin. Një mister i përbashkët për shumë njerëz paraqet një dije të përbashkët për të gjithë ithtarët. Gjendja është e tillë edhe te fetë më të thjeshta. Në ndërgjegjen individuale kjo e vërtetë shprehet si vijon: “Ne si pjesëtarë të fisit apo të popullit dimë për ekzistencën e perëndive, ua dimë emrat një e nga një dhe kemi dijeni edhe për

fuqitë mbinjerëzore të tyre”.

Te fetë e mëdha apo të larta, përmbajtja e perceptimeve përbashkuese nuk është një mit konkret, material, por një doktrinë e caktuar. Si rregull, në çdo fe përshkruhet si formulë besimore që përmbledh doktrinën e saj. Lidhja pas fesë përmendet vetëm në kontekstin e përsëritjes së kësaj përmbledhjeje (rezymeje). Në Greqinë antike ky lloj besimi quhet “symbolion” (shenjë). Kështu, formula që shënjon besimin (ose botëkuptimi fetar që përcaktohet me këtë formulë) luan rolin e një flamuri që bashkon dhe pas të cilit ecën çdokush.

Tërësia e perceptimeve dhe ideve fetare, ose botëkuptimi i veçantë i një feje përmbledhet nga vetë themeluesi i fesë, që bën mbledhjen e zbulesave, ose nga shokët, nxënësit apo të afërmit e tij, që brenda një kohe të gjatë nxjerrin në pah një vepër të caktuar. Një rast për të parën është Kurani, kurse për të dytën Dhiata e Re.

Tekstet e shenjta shoqërohen gjithnjë me teologjinë që shpjegon dhe interpreton përmbajtjen teorike të tyre, që i shqyrton ato në mënyrë të hollësishme dhe që gjeneron terminologjinë përkatëse.

Të gjitha fetë i konstatojnë doktrinën e veta në formën e një mësimi besimor ose të një libri të shenjtë. Është për t'u shënuar se disa nga themeluesit e feve të mëdha emërtohen si “mësues”, “mjeshtër” etj. Kjo vlen për Konfucin, Lao Cenë dhe për themeluesin e maniheizmit (Mani, 216-276), dhe tregon rëndësinë e bashkëmendimit lidhur me një mësim fetar që siguron unitetin. Por, marrë në përgjithësi, studimet e bëra rreth teksteve fetare, përfshirë këtu edhe formulat besimore, kanë hapur rrugën e mospërputhjeve në mendime, madje edhe të kontradiktave. Kontradikta të tilla hasen në të gjitha fetë e mëdha. Si përfundim, brenda një feje kanë lindur shkolla, sekte dhe drejtime të ndryshme. Siç e shohim nga rasti i qyteteve të Tebës, Memfisit dhe Heliopolisit të Egjiptit të vjetër, ku shkollat e ndryshme fetare kanë pasur përplasje me njëra-tjetrën, mund të themi se kontradiktat kanë qenë të pranishme edhe në shekujt kur kanë sunduar fetë politeiste. Kontradikta e Egjiptit kishte të bënte me zinxhirin e hierarkisë së perëndive egjiptiane. Krahas kësaj ka pasur edhe tema të tjera të diskutueshme lidhur me doktrinën fetare.

Në çdo vend ku gjenden tekstet e shenjta, në veçanti te fetë universale konstatohen mospërputhje të shumta fetare dhe sektare. Në këtë drejtim janë shumë të rëndësishme kuvendet klerikale në shek. IV, V dhe më vonë. Çështja kryesore e diskutuar nëpër kuvende të tilla ka qenë tema e lidhjes ontologjike mes profetit Jezu dhe Zotit. Përçarja brenda kishës, ndarja në mes të Kishës Perëndimore me



Hans Freyeri (1887-1969) ka lindur në vitin 1887 në qytetin e Leipzigut. Një vit pas ndjekjes së studimeve për teologji, histori, filozofi dhe ekonomi kombëtare në Universitetin e Greifswaldit, vijoi formimin e vet akademik në Leipzig duke braktisur teologjinë. Në vitin 1925 themeloi Katedrën e Sociologjisë në Universitetin e Leipzigut, të cilën e drejtoi deri në vitin 1948. Ndërkohë themeloi shkollën leipzigase të sociologjisë, e bazuar në histori. Pas Luftës së Dytë Botërore u nda nga detyra që ushtronte në Leipzig dhe kaloi në Wiesbaden dhe Münster, ku punoi për njëfarë kohe dhe, më pas, nga viti 1954, u bë pjesë e trupit mësimor të Universitetit Ankara, ku luajti një rol me peshë në themelimin e Institutit të Sociologjisë. Lista e veprave të tij është shumë e gjatë:

- Antäus. Grundlegung einer Ethik des bewußten Lebens (Antäus. Themelimi i një etike të jetës së vetëdijshme), 1918.
- Die Bewertung der Wirtschaft im philosophischen Denken des 19. Jahrhunderts (Vlerësimi i ekonomisë në mendimin filozofik të shekullit XIX), 1921.
- Prometheus. Ideen zur Philosophie der Kultur (Prometheu. Idetë lidhur me filozofinë e kulturës), 1923.
- Theorie des objektiven Geistes. Eine Einleitung in die Kulturphilosophie (Teoria e shpirtit objektiv. Një hyrje në filozofinë e kulturës), 1923.
- Der Staat (Shteti), 1925.
- Soziologie als Wirklichkeitswissenschaft. Logische Grundlegung des Systems der Soziologie (Sociologjia si shkencë e së vërtetës. Themelimi/mbështetja logjike e sistemit të sociologjisë), 1930.
- Einleitung in die Soziologie (Hyrje në sociologji), 1931.
- Die Revolution von rechts (Revolucioni i së djathtës), 1931.
- Herrschaft und Planung. Zwei Grundbegriffe der politischen Ethik (Sundimi dhe planifikimi. Dy koncepte bazë të etikës politike), 1933.
- Pallas Athene. Ethik des politischen Volkes (Pallas Athene. Etika e popullit politik), 1935.
- Über Fichtes Machiavelli-Aufsatz (Mbi trajtesën e Fichte-s për Makiavelin), 1936.
- Die politische Insel. Eine Geschichte der Utopien von Platon bis zur Gegenwart (Ishulli politik. Një histori e utopive që nga Platoni e deri në ditët tona), 1936.
- Vom geschichtlichen Selbstbewußtsein des 20. Jahrhunderts (Nga vetëvetëdija historike e shekullit XX), 1937.
- Gesellschaft und Geschichte (Shoqëria dhe historia), 1937.
- Machiavelli (Makiaveli), 1938.
- Weltgeschichte Europas, 2 Bände (Historia botërore e Evropës), 2 vëllime, 1948.
- Theorie des gegenwärtigen Zeitalters (Teoria e epokës së sotme), 1955.
- Schwelle der Zeiten. Beiträge zur Soziologie der Kultur (Pragu i kohëve. Kontribute për sociologjinë e kulturës), 1965.
- Entwicklungstendenzen und Probleme der modernen Industriegesellschaft, in: Industriegesellschaft in Ost und West, Mainz (Tendencat e zhvillimit dhe problemet e shoqërisë moderne industriale, në: Shoqëria industriale në Lindje dhe Perëndim), Mainz.
- Herrschaft, Planung und Technik. Aufsätze zur Soziologie, published and introduced by Elfriede Üner (Sundimi, planifikimi dhe teknika. Trajtesa rreth sociologjisë, botuar dhe pajisur me një hyrje nga Elfriede Üner), 1987. (Përpiloi: Ali Pajaziti)

qendër në Romë dhe asaj Lindore ka filluar me polemikat lidhur me këtë çështje.

Mospërputhjet rreth doktrinës fetare nuk janë specifike vetëm për krishterimin, por edhe për fetë e tjera të mëdha. Një shembull për këtë janë dallimet mes budizmit mahajana dhe atij hinajana. Interpretimi i parimeve fetare është shumë i rëndësishëm për individët, kurse doktrina i ndan dhe i largon njerëzit. Në Angli, në periudhën e reformave fetare, ithtarët e largimit të doktrinës fetare nga thelbi janë quajtur opozitarë, kundërshtarë ose sektarë (dissenters) dhe e kanë shfaqur veten me këtë emërtim. Përçarje të tilla shënohen në të gjitha fetë universale dhe, në fakt, ato e dërrmojnë unitetin fetar.

Nga ana tjetër, ithtarët e një besimi të shkëputur nga baza janë shumë më solidarë me njëri-tjetrin. Vihet re se raportit mes ndikimit bashkues dhe veçues të doktrinës fetare është shumë i ndërlikuar.

ii. Çdo fe përmban perceptime që kanë të bëjnë me bindje dhe sjellje të shenjta, kurse fetë universale përmbajnë ide. Por, duhet shënuar se asnjë fe nuk është përmbledhje perceptimesh dhe idesh. Në fakt, feja nuk është vetëm çështje qëndrimi, perceptimi, mendimi apo të konceptuari - ajo është edhe çështje ndjenje dhe vullneti.

Ekzistojnë teori të filozofisë së fesë që pretendojnë se feja është identiteti vetëm i disa perceptimeve. Feja është kuptuar në këtë mënyrë në periudhën e Rilindjes dhe më vonë në shek. XIX. Sipas kësaj pikëpamjeje, feja është një botëkuptim, një filozofi, një koncept parashkencor që ka mbetur në nivelin e perceptimeve konkrete dhe që s'ka arritur atë të koncepteve abstrakte.

Përfaqësuesi më i zgjedhur i kësaj pikëpamjeje është Auguste Comte. Sipas tij, në historinë e njerëzimit janë shënuar tri faza kryesore që ndryshojnë për nga kryesore që ndryshojnë për nga botëkuptimi, mendimi dhe ideologjia mbizotëruese. Në antikitet, që është faza më e gjatë e historisë njerëzore, njeriu mendonte rreth vetes disa qenie dhe fuqi të jashtëzakonshme. Në këtë periudhë, ngjarjet përreth që mund të ndikonin të ardhmen, si furtuna, stuhitë etj., njeriu është përpjekur t'i shpjegojë përmes qenieve dhe fuqive që u përmendën. E shprehur me fjalët e Comtesë, kjo periudhë paraqet periudhën fetare ose teologjike të të menduarit. Në këtë epokë feja ishte mënyrë e të menduarit, mënyrë shpjegimi dhe interpretimi për fenomene të ndryshme natyrore.

Sipas Comtesë, më pas kanë vijuar dy periudha: ajo e mendimit metafizik, ku ndodhitë e ndryshme nuk janë interpretuar duke u dhënë kuptim hyjnor, por janë shpjeguar përmes termave abstraktë tejnatyrorë, si thelbi, fuqia natyrore, graviteti etj. Në periudhën e tretë kjo mënyrë metafizike e të menduarit është zëvendësuar me atë pozitive, ku



janë braktisur termat metafizikë dhe ka mbizotëruar mendimi puro-shkencor. Sipas këtij botëkuptimi, feja përbën një parashkencë. Pra, kur arsyeja njerëzore arrin nivelin për ta kuptuar shkencën abstrakte, feja e humbet vlerën.

Gabimi i kësaj teorie, sikurse edhe i të gjitha teorive që mundohen ta shpjegojnë fenë vetëm në saje të arsyes, është të konsideruarit e një pike të përbashkët si një veçori e vetme e rëndësishme. E vërteta është se çdo fe, qoftë mitologjike, qoftë botërore, s'është vetëm përmbledhje perceptimesh dhe idesh, por qëndrim i brendshëm dhe i jashtëm i njeriut. Qëndrimin e dukshëm e quajmë sjellje dhe një shembull për këtë është ceremonia fetare, jetësimi i një kërkese të Zbulesës, ritet dhe adhurimet e ndryshme. Kurse një qëndrim i brendshëm është lutja. Të gjitha këto nuk janë dukuri të arsyes teorie, por sjellje të vullnetshme.

Në këtë mënyrë arrijmë tek aspekti i dytë i fesë. Tani le ta analizojmë ndikimin bashkëindërtues të fesë. Le të theksojmë se mes këtyre dy elementeve të fesë, njëri perceptiv, tjetri i vullnetshëm, pra nga njëra anë legjendat dhe mitet, nga ana tjetër adhurimet dhe sjelljet fetare, ka një lidhje të pashkëpu-tshme.

Autor i një sjelljeje, i një veprimi apo i një akti adhurimi, i veprimeve që tregojnë respektin e brendshëm, i një rituali fetar dhe i akteve të ngjashme janë njerëzit. Por, këto sjellje i tejkalojnë njerëzit dhe kanë ndikim edhe tek individë të tjerë përreth. Veprimet që rrezatojnë jetën fetare i afrojnë njerëzit që kanë perceptime dhe bindje të përbashkëta shumë më tepër. Ndikimi shoqëror është i veprimeve të përbashkëta është

një fakt i konstatuar nga psikologët. Çdo njeri në veprimet kolektive shndërrohet në qenie tejetindividuale dhe në organ të së tërës; është kjo tërësi që i udhëheq individët, që i çon përpara dhe që i mobilizon ata. Njerëzit i bashkon madje edhe heshtja kolektive.

Nëse anëtarët e një bashkësie shfaqin sjellje të njëjta, kjo do të thotë se ata ndjekin një vijë të njëjtë. Në fillim, një ose më shumë njerëz nisin të bëjnë një veprim, më pas u bashkohen të tjerë; njëri ia nis këngës, të tjerët e ndjekin. Ky është një ligj që ka të bëjë me strukturën e brendshme të aksioneve të bashkësisë, që përfshin edhe veprimet jashtëfetare. Kjo vlen edhe për vallet. Në shembullin e fundit gjithnjë prin një individ ose disa prej tyre; ata nuk dalin jashtë shoqërisë, ata përzgjidhen nga mesi i anëtarëve të tjerë. Jashtë bashkësisë, kohë pas kohe mund të dalë edhe ai që prin ritualin fetar. Roli i tij ndryshon në varësi të kontekstit. Edhe kjo gjendje, në një mënyrë apo në një tjetër, mund të ndikojë në organizimin e bashkësisë. Rrjedhojë e këtyre zhvillimeve është një grup i veçantë që prin në ritualin fetar, pra ai i klerikëve. Rrënjëzimi i formave të ritualeve dhe adhurimeve ka të bëjë me një diferencim të kësaj natyre që realizohet brendapërbrenda bashkësisë fetare.

Një nga llojet e ritualeve dhe adhurimeve është ai që quhet përshkrues. Kjo nuk nënkupton vetëm meditimin dhe përfytyrimin e shenjtërisë, por edhe përshkrimin e saj përmes sjelljeve. Në Greqinë antike ka pasur dy mënyra për të gjallëruar mitet: logosi (fjalë, teori, doktrinë) dhe drama (veprim, ekzekutim). Drama greke për nga burimi është një akt me qëllime

fetare. Siç dihet, në Greqinë antike tragjeditë e mëdha ishin manifes-time që bëheshin për zotin mitologjik Dionis, kurse tema ishte gjithnjë jetëshkrimi i perëndive, gjysmëperëndive dhe heronjve të ndryshëm njerëzorë. Duhet shënuar se ritualet dhe adhurimet përshkruese nuk janë specifike vetëm për fetë mitologjike. Gjurmët e tyre i gjejmë edhe në fetë e larta. Një dëshmi për këtë është ilustrimi dramatik i torturave të Jezuit nëpër kishat e krishterimit mesjetar.

Studimet rreth feve primitive kanë treguar se grupet fetare e kanë ruajtur vazhdimësinë e vet përmes disa ceremonive fetare, nëpërmjet të cilave njerëzit kanë arritur të sigurojnë njëfarë uniteti jetësor. Te këto grupe s'ka veprimtari pa pamje fetare, nuk ka aktivitet që s'është stolitur me një ceremoni fetare. Ngjarjet themelore dhe të rëndësishme si lindja e fëmijës, pranimi i një të riu mes të rriturve, martesat, varrimi, kumti për luftë, fillimi dhe përfundimi i korrijshirjeve janë realizuar gjithnjë me rituale fetare. Këto rite fetare janë më të vazhdueshme se imagjinata që i prodhon. Imagjinata dhe idetë ku bazohen këto rite, me kalimin e kohës e humbin gjallërinë dhe qartësinë në mendjen e njeriut, por ritet në fjalë bëhen në pajtim me traditat. Këto të dhëna tregojnë se ritet dhe ceremonitë fetare, me fjalë të tjera, aktivitetet fetare, kanë një fuqi bashkuese të doktrinës fetare, madje edhe më të fortë se ajo. Në këtë drejtim tingëllojnë të vërteta fjalët e Francis Baconit (1561-1926): Religio praecipuum vinculum societatis - Feja është zinxhiri më i fortë shoqëror.

Në vazhdim do të ndalemi te një mendim i Konfucit lidhur me temën në fjalë. Siç dihet,

konfucianizmi është një religjion racional. Për këtë arsye, në tekstet teologjike përmendet më tepër si një shkollë filozofike, si një botëkuptim etik, si një urtësi politike sesa si një fe. Në shkrimet e Konfucit theksohet se rëndësi parësore ka kryerja e ritualeve dhe e ceremonive fetare pa kurrfarë ndryshimi, pasi jetëgjatësia e shtetit dhe e shoqërisë varet prej këtij elementi, gjëra këto që e përforcojnë unitetin shoqëror. Pra, bëhet fjalë për një koncept të avancuar që shënon ndikimin koheziv të aktiviteteve fetare.

Sot shumë fe e vërtetojnë këtë realitet. Shembuj të shumtë që kanë të bëjnë me këtë segment të jetës fetare vërejmë anekënd botës. Për shembull, në Kishën Katolike ka pesëdhjetë vjet që është shfaqur një rrymë që në ritet fetare dhe lutjet që lexohen në ceremonitë fetare ndjek pëllëmbë pas pëllëmbë metodat e vjetra. Prije dhe rryma të tilla ka edhe në Kishën e Lindjes dhe në budizmin mahajana.

iii. Çdo fe, në veçanti ato të mëdhatë, përveç subjekteve thelbësore të fesë, përfshin një thesar të pasur mendimesh rreth të gjitha çështjeve të rëndësishme të jetës, rreth çështjeve relevante të jetës. Feja sjell një shpirt, një frymë dhe të gjithë besimtarët e besojnë, e kolektivizojnë atë. Kjo përbashkësi e frymës ndikon në jetën e tyre në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme. Kjo është pika e tretë që duhet fokusuar nga këndvështrimi i impaktit përbashkues të fesë.

Nuk është e lehtë që fryma e një feje të shpjegohet me fjalë, të numërohen elementet përbërës të saj. Një nga shërbimet e rëndësishme që ka bërë Marxi për shkencën është përpjekja për

ta shpjeguar shpirtin përmes shembujve. Feja e shtyn njeriun të marrë qëndrim ndaj çështjeve jofetare dhe të evoluojë natyrën, historinë dhe kulturën. Kufiri në mes të tejbotores dhe botërores është një nga elementet që e ndan një fe nga tjetra. Mënyra e vlerësimit të botës profane si një tërësi, si një gjë e mirë apo e keqe, si një gjë nga e cila mund të dalë e mira dhe e keqja, si një lëndë që nuk përfshin një vlerë vetvetiu, varet drejtpërdrejt nga ky konstatim. Vedat, si një prej shënimeve më të vjetra të fesë hinduse, paraqesin një nga shembujt e perceptimit të botës si gjë e mirë (si një dhunti). Përkundër kësaj, koncepti i budizmit ndërtohet mbi idenë se gjithësia është përplot keqësi dhe hidhërim, se është e privuar nga drejtësia, se është një ëndërr e kotë e kalimtare.

Mes qëndrimin pozitiv, optimist dhe atij plotësisht mohues, refuzues dhe pesimist për botën, shënohen shumë gjendje kalimtare. Si në islam, ashtu edhe në krishterim dhe hebra-izëm, ekzistojnë qëndrime ekstreme lidhur me botën. Sipas botëkuptimit të këtyre feve, bota jashtëfetare, sado që s'është e shenjtë, në vetvete bart potencialin e shenjtëritimit. Ndonëse jo të gjitha pasqyrimet e saj janë të mira, është e hapur për të pëlqyer të mirën. Shpirti i këtyre feve shpjegohet pikërisht në këtë mënyrë. Një e vërtetë e dukshme është edhe ajo se pjesëtarët e një feje kanë një qëndrim të njëjtë ndaj botës dhe ky element i bashkon njerëzit; pjesëtarëve të kombeve dhe kulturave të ndryshme u jep një fuqi formësuese.

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Përktheu: Ali Pajaziti)

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Kuka: Shpresoj të fitoj medalje në 'Tokio 2020'

Loriana Kuka mund të jetë sportistja e tretë që i sjell Kosovës medalje nga Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". "Unë po ndihem mirë dhe besoj në punën tonë, kështu që jam e qetë. Ëndërr e imja ka qenë të shkoj në Olimpiadë dhe shpresoj të shkoj gjithçka mirë dhe të rikthehem me medalje", ka thënë Kuka



## "Epoka e re"

**PRISHTINË, 28 KORRIK** - Sot (e enjte) në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020" garon xhudistja Loriana Kuka. Loriana është edhe një shpresë e Kosovës që ta rrëmbejë medaljen e tretë në Olimpiadën që po mbahet në Tokio. Kuka është medaliste e bronzitë e botës dhe Evropës, kurse në "Tokio 2020" garon në kategorinë -78 kg. Ajo ka thënë se është e qetë

dhe se beson shumë se nga Tokio do të rikthehet me medalje. "Unë po ndihem mirë dhe besoj në punën tonë, kështu që jam e qetë. Ëndërr e imja ka qenë të shkoj në Olimpiadë dhe shpresoj të shkoj gjithçka mirë dhe të rikthehem me medalje", ka thënë Kuka.

Garat e xhudos nisën prej orës 04:00 me kohën tonë lokale, por Loriana raundin e parë e ka kaluar pa luftë dhe ajo nis garimin rreth orës 05:00. Kampionia e Evropës U-23 do të

ketë punë me fituesen e duelit në mes të Marie Branser e Aleksandra Babintseva.

Kosova ka fituar dy medalje të arta në "Tokio 2020", ku Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova ishin fenomenale dhe arritën t'i sjellin Kosovës një sukses të jashtëzakonshëm, sukses të cilin e kishte sjell edhe Majlinda Kelmendi në Lojërat Olimpikë "Rio 2016", ndërsa në "Tokio 2020" Majlinda Kelmendi dhe Akil Gjakova mbeten pa medalje.

## SHKURT

### 4 gjyqtarë të Kosovës delegohen në dy ndeshje të Europa Conference League

Katër gjyqtarët e Kosovës janë deleguar nga UEFA për ta ndarë drejtësinë në Ligën e Konferencës. Është gjyqtari Besfort Kasumi ai i cili do ta gjykojë ndeshjen e kthimit të raundit të dytë të Ligës së Konferencës ndërmjet skuadrës rumune Sepsi Sfantu Gheorghe dhe skuadrës sllovaqe Spartak Trnava. Asistentë të Kasumit në këtë ndeshje do të jenë Edmond Zeqiri e Fatmir Sekiraga, kurse gjyqtar i katërt Shpëtim Murtezi. Kjo ndeshje zhvillohet të enjten në orën 18:30 në stadiumin "Stadionul Municipal". Delegimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve të Kosovës në ndeshjen e garave të UEFA-s është një tjetër përparim për FFK-në dhe për Komisionin e Gjyqtarëve, pasi po dëshmohet puna e mirë që bëjnë gjyqtarët tanë.

### Peshëngritësi shqiptar për 1 kg mbetet pa medalje

Peshëngritësi Briken Caljes e ka përfunduar garimin në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". Peshëngritësi shqiptar zhvilloi një paraqitje shumë të mirë, duke u renditur në vend të katërt në Olimpiadë. 31-vjeçari e mbylli me 151 kg të ngritura në stilin e shkëputjes në Lojërat Olimpikë të Tokios. Vendi i shtatë për Caljen në shkëputje, teksa ka bërë shumë më mirë në stilin e shtytjes. Calja çoi 184 kg në tentativën e parë, ndërsa dështoi në të dytën me 188 kg. Fantastike prova e tretë e peshëngritësit nga Elbasani, i cili ia doli të çojë 190 kg. Sportisti kuçezi e mbylli dygarëshin me 341 kg të ngritura, duke u renditur në vend të katërt në dygarësh. Vetëm 1 kg ishte Calja larg medaljes së bronzitë.

### Hetemaj nga Benevento kalon te Reggina

Përparim Hetemaj është paraqitur te skuadra e Serisë B, Reggina. Skuadra italiane ka njoftuar se e ka transferuar futbollistin me prejardhje shqiptare. Hetemaj ishte pjesë e skuadrës Benevento e cila sezonin e fundit u promovua në Serinë A, kurse ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me Regginan deri në vitin 2022.

### Sadiku mbyll aventurën te Bolivari, kërkohet nga Las Palmasi

Armando Sadiku nuk është më lojtar i skuadrës së Bolivarit dhe tashmë mbetet një lojtar i lirë. Ka zgjatur shumë pak aventura e tij me skuadrën e njohur nga Bolivia, rreth gjashtë muaj pas transferimit nga Erzurumspor. Këtë lajm e ka konfirmuar vetë klubi i Bolivarit me anë të një postimi në profilin e vet zyrtar në "Twitter", ku njoftojnë se kanë arritur pajtimin e prishjes së kontratës me sulmuesin e kombëtares shqiptare. Sipas asaj që raporton iberikja "El Desmarque", 30-vjeçari elbasanas mund ta vazhdojë karrierën e tij në Spanjë më konkretisht te skuadra e Las Palmas, e cila militon në kategorinë e dytë spanjolle. Sadiku në 15 ndeshje me Bolivarin mundi ta tundte rrjetën vetëm dy herë.

## Më 20 gusht shorti për Kosovën A

**PRISHTINË, 28 KORRIK** - Më 20 gusht në Gjermani do të hidhet shorti për rrethin e parë parakualifikues të FIBA Eurobasket 2025, ku do të mësohen edhe kundërshtarët e Kosovës A në

konkurrencën e meshkujve. Në short do të jetë i pranishëm drejtori i Përfaqësuesëve të Kosovës, Granit Rugova. Shorti do të hidhet nga ora 11:45 më 20 gusht. Pas hedhjes së

shortit do të bëhen të ditura edhe datat se kur do të luajë Kosova A te meshkujt. Kosova A është në vendin e 70 të renditjes së FIBA-s dhe në vendin e 37 në Evropë.



## Xhaka, pas largimit të Petkoviçit: Ne e shkruam historinë së bashku

CYRIH, 28 KORRIK - Granit Xhaka e ka falënderuar Vladimir Petkoviçin përmes një shkrimi emocional në rrjetet sociale, pasi trajneri boshnjak e la Kombëtaren e Zvicrës për ta marrë drejtimin e klubit elitare francez, Bordeaux. 57-vjeçari e

kishte marrë në dorë ekipin kombëtar helvetik në vitin 2014, duke e pasur Ottmar Hitzfeld. “Çfarë udhëtimi. Zotëri, dua thjesht të të falënderoj për gjithçka. Ne e shkruam historinë së bashku! Ka qenë një rrugëtim i jashtëzakonshëm”, ka shkruar

Xhaka në “Instagram”. “Faleminderit për punën tuaj të zellshme, për përkrahjen dhe për mënyrën sesi e ke shndërruar një ekip kombëtar në një grup vëllezërisht. Ne nuk e harrojmë punën tuaj dhe t’i urojmë të gjithë të mirat në Bordeaux”, ka

shtuar Xhaka. Futbollisti shqiptar luajti nën urdhrat e Petkoviçit në tre turne të mëdhenj, “Euro 2016”, Kupën e Botës 2018 dhe “Euro 2020”. Por Euro 2020 ishte suksesi i tyre më i madh, pasi ata e udhëhoqën Zvicrën drejt çerekfinaleve së parë në një turne



të madh në historinë e vet, duke e mundur kampionen e botës, Francën, në 1/8 e finales.

## Zhdrella vazhdon kontratën me Llapin

PODUJEVË, 28 KORRIK - Klubi i futbollit, Llapi, ka njoftuar se ka arritur marrëveshje për zgjatjen e kontratës me mesfushorin Mentor Zhdrella. Ky i fundit ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me klubin llapian, kurse lajmin e ka dhënë vetë klubi i Llapit nëpërmjet rrjeteve sociale. Siç dihet, mesfushori me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës në përfundim të edicionit 2020/21 u largua nga kjo skuadër, pasi nuk gjeti gjuhë të përbashkët për vazhdimin e kontratës. “Kapiteni Mentor Zhdrella vazhdon bashkëpunimin me Llapin edhe për një edicion tjetër. Jo më kot thonë se futbollit krijon familje. Kemi kënaqësinë t’juaj kumtojmë lajmin se kapiteni Mentor Zhdrella është përsëri pjesë e familjes bardhekaltër. Pas katër vjetësh bashkëpunimi (2017-2021), kapiteni me 100



paraqitje, 20 gola e 30 asistime, do të japë kontribut për ekipin e vendlindjes edhe në vitin e pestë me radhë. Pas konsullatave me presidentin Beqir Batatina,

kapiteni Zhdrella, i rikuperuar plotësisht nga lëndimet, do të vazhdojë t’i prijë skuadrës drejt sukseseve”, thuhet në njoftimin e plotë të Llapit.

## Russell: Jam një pilot i Mercedesit, nuk shkoj kurrë te Red Bull apo Ferrari

LONDËR, 28 KORRIK - Piloti i ri britanik George Russell, që aktualisht garon me makinën Williams, ka deklaruar nga Hungaria, ku të dielën zhvillohet gara e radhës së botërorit të Formula 1, se nuk do të shkojë kurrë të pilotojë një makinë Red Bull apo Ferrari. 22-vjeçari ka dalë nga academia Mercedes dhe ai shprehet se edhe në të ardhmen do të pilotojë një makinë që ka motorin e makinës gjermane.

“E sigurt është se do të pilotoj një makinë që ka motor Mercedes. Jam një pilot besnik i kësaj makine, që ka investuar tek unë dhe më ka mbështetur që kur isha i vogël. Unë nuk e di nëse vitin tjetër do të pilotoj një makinë që ka motorin Mercedes



apo vetë makinën Mercedes, këtë gjë e vendosin të tjerët”, ka thënë Russell. Kohët e fundit është përfolur për një interesim të Red Bullit, por piloti i ri britanik shuan çdo shpresë të makinës austriake. “Më vjen

mirë kur dëgjoj një interesim të tillë apo kur dëgjoj fjalë të mira nga rivalët, por unë jam besnik i Mercedesit dhe për mua është e pamundur të pilotoj një Red Bull apo Ferrari vitin e ardhshëm”, ka deklaruar Russell.

### SHKURT

#### Gjermania zhgënjën edhe në Olimpiadë

Gjermania në futboll po kalon një periudhë tranzicioni, pasi sot është eliminuar edhe nga Olimpiada në Tokio. “Pancerat” e kanë mbyllur fazën e grupeve në vendin e tretë me një fitore, një barazim dhe një humbje. Në ndeshjen e tretë në grup Gjermania barazoi 1-1 me Bregun e Fildishtë, pikë që nuk i mjaftoi për të kaluar më tej, pasi biletën e siguroi kombëtarja afrikane. Në krye të grupit u rendit Brazili me dy fitore dhe një barazim, ku në ndeshjen e tretë mposhti 3-1 Arabinë Saudite e cila e mbylli grupin në vendin e fundit.

#### Haalandi: 175 milionë euro janë shumë për një futbollist

Sulmuesi Erling Haaland nuk beson se Chelsea do të japë 175 milionë euro për ta blerë atë nga Borussia Dortmundi. Norvegjezi i quan thashetheme këto lajme dhe shumë e përfolur e konsideron shumë para për një lojtar të vetëm. Ai ndërkohë thotë se ka folur me agentin dhe brenda muajit do të ketë një përgjigje teksa thekson se ka dhe tre vjet kontratë me Dortmundin. “Unë me të vërtetë nuk kam shumë për të thënë për këtë. Më kanë mbetur tre vjet nga kontrata dhe po shijoj kohën time këtu. Përdje nuk fola me agentin tim brenda një muaji. Mendoj se e keni përgjigjen atje. Në të vërtetë nuk më intereson shumë për këtë. Janë shumë para. Shpresoj se janë vetëm thashetheme për të qenë të sigurtë se këto janë shumë para për një person”, ka thënë Haaland.

#### Alaba rezulton pozitiv me Covid-19

Futbollisti i ri i Real Madridit, David Alaba, ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Alaba është lojtari i dytë pas Karim Benzemas që ka rezultuar pozitiv te “Los Blancos”. Alaba ka rezultuar pozitiv në testimin e fundit me metodën PCR. Ai tashmë është vetizoluuar dhe është duke iu nënshtruar protokolleve anti-COVID-19. Siç dihet, futbollisti austriak gjatë kësaj vere u largua nga Bayern Muncheni dhe u transferua në Real Madrid.

#### Joshua refuzoi ofertën mbi 10 milionë euro për t’u larguar nga Hearn

Anthony Joshua ka zbuluar se ka refuzuar mbi dhjetë milionë euro për t’u larguar nga promovuesi Eddie Hearn dhe të vazhdojë me një të ri. Kampioni i peshave të rënda në WBA, IBO, IBF dhe WBO, është duke u përgatitur aktualisht të përballet me Oleksandr Usyk. Ukrainasi tenton të fitojë titullin WBO që mbahet nga AJ, me këtë të fundit që zbuloi se si ka pranuar ofertën që ta shkëpusë marrëveshjen me Hearn. Duke folur me Gary Neville në emisionin e tij The Overlap, Joshua zbuloi ofertën, ndërsa foli më gjerë për natyrën e marrëdhënies së tij me Hearn dhe kompaninë promovuese “Matchroom Boxing”. “Kjo varet vërtet nga tregtia juaj”, shpjegoi Joshua kur u pyet për ndarjen e parave në kontratën e një boksieri. “Unë thjesht mund t’ju ofroj një tarifë, kështu që nuk është sikur t’ju zotëroj, por mund t’i blej të drejtat tuaja të imazhit dhe të them se dua t’i blej të drejta për të gjitha fitimet tuaja të ardhshme. Mund të bëj marrëveshje me këdo, madje ishte një ofertë mbi dhjetë milionë euro që të nënshkruaj me një kompani por, jo, nuk më bindin këto gjëra”, ka shtuar boksieri britanik.

## Medalja e fundit e artë e Britanisë së Madhe ka thyer një rekord Olimpik 113-vjeçar

Sportistët e Britanisë së Madhe siguruan një tjetër medalje të artë në pishinën olimpikë me një fitore dominuese në stafetën 4x200 metra të stilit të lirë në not në Lojërat Olimpikë “Tokio 2020”. Katërshja apo kuarteti i Britanisë së madhe në 200 metra i përbërë nga Tom

Dean, Duncan Scott, James Guy dhe Matthew Richards fituan garën dhe arritën brenda 0,03 sekondave të rekordit botëror në një performancë mahnitëse. Kuarteti britanik fitoi në gjashtë minuta 58.58 sekonda – 3.23 sekonda të qarta nga Komiteti Olimpik rus, ndërsa Australia

fitoi medaljen e bronzit. Britania e Madhe ishte favorite që hyn në garë pasi u kualifikua më shpejt dhe prodhoi atë që ish-olimpiku Mark Foster e përshkroi si një “demonstrim i një performancë”. Fitorja do të thotë që Dean bëhet notari i parë britanik që fiton dy medalje ari në të

njëjtat Lojëra Olimpikë që nga viti 1908. Kjo është, gjithashtu, hera e parë në 113 vjet që Britania e Madhe ka fituar tri medalje ari në not në një Olimpiadë. Pas fitimit të medaljes së artë, emocionet ishin të mëdha tek ekipi britanik, teksa nuk munguan as lotët.



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë

Rr"Motrat Qiriazi" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, [www.kolegjobiznesi.com](http://www.kolegjobiznesi.com), [info@kolegjobiznesi.com](mailto:info@kolegjobiznesi.com)  
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **28.07.2021**, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

**SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STUDENTAVE PËR VITIN AKADEMIK 2021/2022**

**STUDIME BACHELOR**

1. BANKA DHE FINANCA NË BIZNES (BA) - (3 vjeçar)
2. MENAXHMENT DHE EKONOMIKS (BA) - (3 vjeçar)
3. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE (BA) - (3 vjeçar)
4. JURIDIK / LLB - (4 vjeçar)

**STUDIME MASTER**

1. MENAXHMENT DHE FINANCA – MA-(2 vjeçar)
2. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE – MA-(2 vjeçar)

[www.kolegjobiznesi.com](http://www.kolegjobiznesi.com),  
[info@kolegjobiznesi.com](mailto:info@kolegjobiznesi.com)

038/045- 500 878 : 029-230-555  
044/ 049/ 048- 500 – 878

**SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK**

**I. PROFESORA**

1. Pesë (5) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin
2. Gjashtë (6) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin
3. Gjashtë (6) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin
4. Pesë (5) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin
5. Pesë (5) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin
6. Pesë (5) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin

**MENAXHMENT DHE EKONOMIKS - BA**  
**JURIDIK LLB**  
**MENAXHIMI I EMERGJENCAVE - BA**  
**BANKA DHE FINANCA NË BIZNES - BA**  
**MENAXHMENT DHE FINANCA - MA**  
**MENAXHIMI I EMERGJENCAVE - MA**

**II. ASISTENTA**

1. Tre (3) asistent për lëndë ekonomike,
2. Tre (3) asistent për lëndë juridike,
3. Tre (3) asistent për lëndë të emergjencave,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

**Për vendin e punës mësimdhënës**, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse.

**Për vendin e punës asistent**, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar studimet Master në lëmin përkatëse, preferohet të kenë të regjistruar studimet e doktoratës (PhD).

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet Master jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **30.7.2021 deri më 09.08.2021**.

Paraqitja e dokumenteve: Rr.Motrat Qiriazi 29, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: [info@kolegjobiznesi.com](mailto:info@kolegjobiznesi.com)

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: [www.kolegjobiznesi.com](http://www.kolegjobiznesi.com)

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: [www.kolegjobiznesi.com](http://www.kolegjobiznesi.com) ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, " Benita Company ", Sh.p.k.Gremnik, Klinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Depon e karburanteve të lëngëta naftë dhe benzin në Gremnik, Klinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.08.2021 në ora 13:00 në Restorantin e kompanisë " Benita Company ", që gjendet në anën e djathtë të magjistrales Klinë - Gjakovë në kilometrin e parë nga rreth rrotullimi i Klinës në drejtim të Gjakovës. do të organizohet debati publik nga Kompania " Benita Company ", Sh.p.k.Gremnik, Klinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Depon e karburanteve të lëngëta naftë dhe benzin në Gremnik, Klinë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRjI0HhxdmNpUWJCU09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " Benita Company ", Sh.p.k.Gremnik, Klinë për Depon e karburanteve të lëngëta naftë dhe benzin në Gremnik, Klinë.

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure*

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë për Kushtet Ndërtimore**

"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin "Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Nr. prot: 2369/21 të datës 16.06.2021, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**  
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës  
Departamenti i Planifikimit Hapsinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapsinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapsinor  
[Suzana.goranci@rks-gov.net](mailto:Suzana.goranci@rks-gov.net)  
Telefon: + 381 38 200 32 553

RESTAURANT

---

# SWISS

TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  [www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

► Avdyl Avdyli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV si dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Hanemshah Halili nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçant me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



MEKA  
HALAL FOOD

## PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pulë

cilësi e garantuar

pa konservues